

VENDIM
Nr. 174, datë 27.3.2019

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 634, DATË 1.10.2014, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR VLERËSIMIN DHE
DHËNIEN ME KONCESION/PARTNERITET PUBLIK PRIVAT TË PUNËVE
PUBLIKE DHE SHËRBIMEVE PËR NDËRTIMIN, OPERIMIN, MIRËMBAJTJEN
DHE REHABILITIMIN E RRUGËVE NACIONALE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, pikat 1, shkronja “j”, dhe 2, të ligjit nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 5, e nenit 34, në tekstin “Rregullat për vlerësimin dhe dhënie me koncesion/partneritet publik privat të punëve publike dhe shërbimeve për ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e rrugëve nacionale”, bashkëlidhur vendimit nr. 634, datë 1.10.2014, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“5. Kontrata e koncesionit/PPP do të hyjë në fuqi pas miratimit me ligj nga Kuvendi i Shqipërisë.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama